



REPUBIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-kline.org

Komuna e Klinës

Kuvendi i Komunës

01Nr *06-14700/20* /2020

Klinë, *30.06.2020* 15.05.2020

PROCESVERBAL

I Seancës së III-të, të rregullt, të punës së Kuvendit të Komunës së Klinës, mbajtur më 15. 05. 2020, filluar në ora 10:00, në sallën e Kuvendit të Komunës.

Seanca u organizua nga zyra për punë e Kuvendit në bashkëpunim me kryesuesin e Kuvendit dhe QKMF "Nënë Tereza" në Klinë. Përveç anëtarëve të Kuvendit, kryetarit të Komunës, Nënkryetarit, kom. i Policisë, z. Ragip Bytyqin të cilin kryesuesi i Kuvendit e uroi për detyrën e re dhe i premtoi bashkëpunim si Kuvend. Radio "Alba" dhe drejtorë të drejtorive, nuk kishte pjesëmarrës tjerë në sallë pasi që këto ishin rekomandimet e QKMF-së. Këta të fundit kontrolluan paraprakisht temperaturën trupore të çdo pjesëmarrësi në seancë si dhe bënë furnizimin me dorëza dhe maska mbrojtëse. Anëtarët e kuvendit dhe pjesëmarrësit e tjerë u sistemuan nëpër ulëse të kuvendit dhe të tjera të improvizuara në distance të caktuara nga IKSHPK. Kryesuesi në vazhdim falënderoi në mënyrë të veçantë Këshillin emergjent në krye me kryetarin e Komunës për menaxhimin e situatës si dhe të gjithë mjekët dhe infermierët- stafin në përgjithësi të QKMF-së në Klinë në krye me drejtorin z. Hekuran Sejdiu. Pastaj falënderoi edhe komandantin e policisë së Klinës bashkë me të gjithë policët që shërbejnë në Komunën e Klinës. Si dhe të gjithë qytetarët e Klinës të cilët gjatë kësaj kohe të pandemisë kanë treguar nivel të lartë të përgjegjësisë.

Seancën e hapi kryesuesi i Kuvendit, z. Fadil Gashi i cili përshëndeti gjithë të pranishmit dhe i falënderoi për pjesëmarrje. Kryesuesi, z. Gashi shpjegoi se kjo seancë është dashur që të mbahet me 27 mars porse për shkak të pandemisë nuk ka qenë e mundur që të realizohet. Para se të bëjë prezantimin e Rendit të Ditës, konstatoi se nga 27 anëtarët e Kuvendit , të pranishëm janë 19. Përveç Anëtarëve Baki Gashi i cili është për shërim në Itali dhe anëtares Shqipnora Dauti e cila ka dhënë dorëheqje nga Kuvendi, për mungesën e anëtarëve të tjerë, kryesuesi deklaroi se nuk ka informacione. Ndërsa për rendin e ditës propozoi disa pika shtesë: 1. Propozim –Vendimi për anulimin e mbajtjes së FF "I këndojmë lirisë" për vitin 2020. 2. Ndarja e mjeteve buxhetore në shumën prej 13.000 euro për ndërmarrjen publike "ambienti" në Klinë, 3. Formimi i Komisionit për rimëkëmbje nga pandemia, prej 7 anëtarëve. 4. Formimi i Komisionit për ndarjen e ndihmave, 5 anëtarë, dhe pika 5. Shtesë: Propozim-vendim për lirim të përkohshëm nga gjobat për kategoritë; regjistrim i lindjeve, regjistrim i vdekjeve si dhe shtyrja e afatit për shpenzimet e varrimit. Të gjitha këto përfshihen nga data 13 mars 2020.

Kryesuesi në vazhdim hapi debat për Rendin e ditës duke lajmëruar se në këtë seancë nuk është paraparë pika : Pyetje-Përgjigje.

Me 20 vota Për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, u MIRATUA Rendi I ditës, me pikat shtesë të propozuar më lartë.

Pika 1. E Rendit të Ditës: Arsyetimi I Mungesave

Kryesuesi Gashi, theksoi se tani në sallë janë prezent 20 anëtarë të Kuvendit. Shqipnora Dauti ka dhënë dorëheqje nga të qenurit pjesë e Kuvendit dhe se procedurat e zëvendësimit me anëtarin e re janë në Ministrinë ë linjës ndërsa anëtari Baki Gashi është për shërim në Itali e I cili për shkak të mbylljes së linjave të transportit nuk ka se sit ë vije. Për mungesën e të tjerëve , ai theksoi se nuk ka asnjë konfirmim. Në sallë për momentin janë prezent 21 anëtarë.

Pika 2. E Rendit të ditës: Shqyrtimi dhe Aprovimi I procesverbalit të seancës së kaluar.

Pasi që asnjëri nga anëtarët e Kuvendit nuk kishte asnjë vërejtje për procesverbalin e seancës së kaluar, Procesverbali në fjalë u vendos në votim dhe ai u MIRATUA me 21 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim

Pika 3. E Rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi I rekomandimeve të KPF.

Kryesuesi, z. Fadil Gashi për këtë pikë të rendit të ditës theksoi se anëtarët e kuvendit I kanë dy alternative kur shqyrtojnë rekomandimet e KPF dhe se alternative më e mirë e mundshme është kur të gjithë pajtohen në bllok për rekomandimet e KPF-së. Dhe alternativa e dytë është shqyrtimi veç e veç e të gjitha rekomandimeve. Ai gjithashtu njoftoi të pranishmit se janë dy kërkesa që kanë ardhur pranë këtij Komiteti dhe se të tjerat kërkesat janë në Rendin e ditës si pika për shqyrtim.

Kryesuesi e vuri në votim pajtueshmërinë në bllok me rekomandimet e KPF-së dhe me 21 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, u MIRATUA.

Pika 4 e Rendit të Ditës: Shqyrtimi I Planit të prokurimit për vitin 2020.

z. Abaz Foniqi, zyrtar I Prokurimit: Përshëndetje të gjithëve. Ju e dini që planifikimi I prokurimit është bërë conform ligjit të prokurimit dhe ka pasur disa afate se kur duhet të përgatitet ai preliminar dhe kur ai final. Bazuar në kërkesat e njëjësive kërkuese në komunë dhe buxhetit të miratuar, ne kemi bërë atë plan të prokurimit, plan që ka qenë në shqyrtim edhe në KPF. Ju informoj se sot është është me vonesë sepse atëherë kur është dashur të mbahet mbledhja e rregullt ka qenë afati për dorëzim. Dorëzimin e kemi bërë por ju informoj se kjo nuk do të thotë që ky plan është strikt dhe nuk mund të plotësohet e ndryshohet. Pra ne, mund të propozojmë procedura e projekte të reja por që çdo procedurë e re gjatë vitit dërgohet paraprakisht në AQP. Ligji e lejon dhe s` ka asnjë pengesë që të realizohet projekti I ri I propozuar. Që mos t ë ju vonoj shumë, në këtë planin e prokurimit që ne e kemi pasur të përgatitur janë të parapara 59 procedura. Prej këtyre, 14 për furnizime, 20 për shërbime dhe 25 për projekte apo punë. Për numrin e vogël për furnizime mundë të ju informoj se ne, gjatë këtij viti kemi edhe 58 kontrata kornizë që kane validitet tre vjeçare. Prandaj shumë mallra siç janë letër etj. nuk janë planifikuar për këtë vit, pra , sepse kemi kontratë valide për këtë furnizim. Si dhe 14 procedura të tjera që janë të parapara të bëhen nga niveli qendror, pra t ë centralizuara. Kjo pra është një pasqyrë e planifikimit të prokurimit për vitin 2020. Projektet kapitale sipas një urdhërese që ka ardhur nga KRPP janë suspenduar përveç rasteve të nevojshme për shërbime për qytetarë. Nëse keni ndonjë pyetje, jam në dispozicionin tuaj.

z. Tunë Dedaj: Përshëndetje për të gjithë. Në lidhje me planifikimin e prokurimit jam i interesuar që të informohem drejt për drejt nga zyrtari i prokurimit që bëri prezantimin se çfarë është bërë me rrugën Zajm-Jagodë? Qe një vit ka mbet e pa realizuar duke u futur tre-katër herë në tender dhe anuluar! Nëse kjo rrugë nuk fillon, unë ftoj prokurorinë që të merret me hetimin e këtyre anulimeve që po bëhen në Prishtinë.

z. Abaz Foniqi, zyrtar i Prokurimit: Ky që prezantova unë ishte planifikim. Në lidhje me shqetësimin e shprehur nga Anëtari i Kuvendit, informoj se procedura është filluar në bazë të ligjit për prokurimin publik. Ankesat, operatorëve ekonomik nuk mund të jua mohojmë. Kemi pasur 4 ankesa deri me tani dhe edhe pse nuk jemi pajtuar me vendimet e OSHP-së kemi ardhur deri tek vlerësimi i finalizimit të pestë, po flas për momentin ku jemi. Sot veç ka përfunduar ajo procedurë dhe është plasuar në platformë vendimi për shpërblim me kontratë. Kemi prap një afat ligjor për ankesa, afat prej pesë ditëve dhe nëse ankohet ndonjë nga OE prap do të jemi në të njëjtën situatë. Është OSHP organi më i lartë që ne nuk mund të kundërshtojmë vendimet e tyre.

z. Enver Berisha: Përshëndetje për të gjithë. Ne grupi Kuvendar i PDK-së, dëshirojmë që të bashkohemi urimit për detyrën e re komandantit të Policisë dhe të falënderojmë të gjithë ata që kanë dhënë kontribut gjatë kohës së pandemisë dhe kanë bërë që Klina të jetë në këtë gjendje çfarë është. Kur jemi tek planifikimi i zyrës së prokurimit, në rrethanat që jemi si shkak i pandemisë, secili prej neve ndoshta është i vetëdijshëm se ky plan ka me qenë vështirë i realizuar në plotësi shkak se ka ngecur paksa puna si në inkasime etj. Sido që të jetë, është mirë të kemi kujdesë në punët me prioritet dhe ato që janë në interesin e qytetarëve. Besoj se kështu do të veprohet, prandaj ne e mbështesim këtë plan të prokurimit.

Kryesuesi z. Gashi e vuri në votim planin e prokurimit bashkë me vërejtjen që e bëri z. Tunë Dedaj dhe me 21 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, u MIRATUA.

Pika 5. E Rendit të Ditës: Shqyrtimi i propozimit për venje në diskutim publik të draft plotësim ndryshimeve të rregullores për organizimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në Komunën e Klinës.

Kryesuesi i Kuvendit theksoi se është një rregullore për këtë çështje e aprovuar në vitin 2015 por që ka pasur pengesa në implementimin e saj jo vetëm në Komunën e Klinës por në pjesën dërrmuese të komunave të Kosovës. Tani është udhëzimi administrativ, theksoi kryesuesi, i cili udhëzim është si kërkesë i AKK-së, për një udhëzim unik- rregullore unike i cili shpjegon formatin e zgjedhjeve të këshillave, përgjegjësitë, kompensimin. Ne sot do të votojmë që këtë ta vendosim në debat publik, më pastaj do të kthehet prap në Kuvend, ku do të analizohet, shqyrtohet dhe votohet për të hyrë në fuqi.

z. Enver Berisha: Komisioni për këtë udhëzim është i përbërë edhe nga anëtarët e Kuvendit pasi që po kërkohet që ta votoj kuvendi. Nëse po, a mund t'i dimë emrat e tyre.

z. Binak Sylaj, drejtor i Administratës: Të nderuar të pranishëm. Komisioni i formuar nga kjo asamble, ka hartuar Draft-Plotësimin conform udhëzimit administrative dhe janë mbajtur disa takime radhazi. Atë draft e kemi dorëzuar në zyrën për shërbim të Kuvendit dhe mund të ju rikujtoj se anëtarë janë: Isa Ibishi, Sefa Morina, Binak Sylaj, Ajet Sejdiu dhe Tahire Gashi.

Kryesuesi Gashi e vënë në votim dhe me 21 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, draft rregullorja në fjalë për lëshuarjen në diskutim publik, MIRATOHET.

Pika 6. E Rendit të Ditës: Rishikimi I vendimit për Hartat Zonale sipas udhëzimit të Ministrisë së APL.

Kryesuesi theksoi rëndësinë e HZ për Komunën e Klinës si dhe punën që është bërë për hartimin e tyre. Gjithashtu theksoi se ministria e linjës e ka kthyer në rishikim vendimin e Asamblesë, vendimin e miratimit HZ (HZ-Hartat Zonale). Z. Gashi në vazhdim theksoi se kërkesën e Ministrisë për rishqyrtim do ta shtjelloi drejtori I Urbanizimit ndër të tjera.

z. Lorenc Marleku, drejtor I Urbanizimit: Përshëndetje për të gjithë. HZ janë miratuar me datë 29. 01. 2020. Ministria e infrastrukturës dhe Ambientit ka kërkuar që kjo çështje të rikthehet në Asamblenë Komonale për shkak të bashkimit të ministrive. Kjo është një çështje formale. Në përmbajtje HZ nuk ndryshojnë asgjë, Ndryshimi I vetëm është tek emërtimi prandaj meqenëse me fuzionimin e Ministrisë, kërkohet miratim I ri, Kjo është dashtë të kryhet në seancën e muajit Mars por për shkak të pandemisë nuk janë mbajtur seancat dhe nuk kemi pasur mundësi që ta bëjmë. Kërkojë nga ju që të votoni për. Ju faleminderit.

z. Enver Berisha: Meqenëse ne I kemi votuar HZ, dhe meqenëse nuk ka asnjë ndryshim në përmbajtje përveç se tek titulli, unë e shoh si çështje teknike dhe nuk mendoj që duhet të futemi në debat.

Kryesuesi z. Fadil Gashi pajtohet me parafolësin dhe e vendosë në votim. Me 20 vota për, asnjë kundër dhe një abstenim (Xhevxhet Berisha), u MIRATUAN Hartat Zonale.

z. Xhevxhet Berisha e arsyeton abstenimin e tij në votim të HZ. Ai thekson se arsyeja e vetme është se ai ka pasur nevojë që përmes projektorit të I shohë HZ dhe ato të prezantohen nga Drejtori ose Ministria. Ai theksoi se nuk është kundër HZ por nuk mund të votoi PRO, për diçka që nuk e ka shikuar.

Ndërsa kryesuesi Gashi në lidhje me këtë reagoi ndaj z. Berisha duke thënë se shërbimi I Kuvendit jua ka dërguar të gjithë anëtarëve të Kuvendit HZ në CD dhe se të gjithë anëtarët e kuvendit kanë llaptop të cilët llaptop jua ka siguruar Komuna.

Pika 7. E Rendit të Ditës: Vendimi për plotësimin e anëtarit të Komitetit Konsultativ për Bujqësi, zhvillim rural dhe mbrojtje të mjedisit, sipas komisionit intervistues.

Kryesuesi theksoi se komitetet konsultative trajtohen me udhëzim të veçantë dhe në rastin konkret është dashur të hapet konkurs për pranimin e anëtarit të ri, konkurs I cili është hapur dhe ka përfunduar edhe intervistimi. Z. Gashi tha se në raportin që e kemi marr të gjithë, komisioni intervistues sipas vlerësimit me pikë të kandidatëve, propozon Arlind Morina që të votohet për anëtar I këtij Komiteti. Këtë propozim e vendos në votim dhe me 22 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, MIRATOHET propozimi që Arlind Morina të jetë anëtar I Komitetit në fjalë.

Pika 8 e Rendit të Ditës: Vendimi për anulimin e organizimit të FF"l këndojmë lirisë" për vitin 2020.

Kryesuesi I Kuvendit sqaron se pas këshillimit me kryetarin e Komunës, kërkesën e Drejtorisë së Kulturës dhe rekomandimet e IKSHPK e vendimin e Qeverisë për anulimin e tubimeve publike, për shkak të rrezikut të shpërndarjes së virusit COVID-19, propozojmë që Festivalin në fjalë të cilin e ka themeluar Kuvendi I Komunës, të votojmë që të anulohet për këtë vit. Ai tha se kërkon mirëkuptimin e të gjithëve.

Me 22 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim u MIRATUA, anulimi I organizimit të FF për këtë vit.

Pika e 9. E Rendit të Ditës: Ndarja e mjeteve buxhetore për ndërmarrjen publike "Ambienti" në Klinë.

z. Tunë Dedaj: Nuk jam kundër ndarjes së këtyre mjeteve për kompaninë në fjalë por jam kundër atyre që tani e tre javë në kanë lënë mbeturinat pa l hequr. Prandaj ndarja e këtyre mjeteve po më duket e tepërt. Por nëse ju jeni dakort që të ju ndahen këto mjete, në rregull, unë do të ju përkrahu por kërkojë që të jenë më të angazhuar dhe të përgjegjshëm në marrjen e mbeturinave.

z. Gjokë Lleshaj: Përshëndetje për të gjithë. Unë kam qenë drejtor i Shërbimeve Publike dhe e di gjendjen reale të punës që bënë kompania por edhe inkasimit të mjeteve nga qytetarët. Duke e ditur se sa obligimin e pa kryer e kanë qytetarët e Komunës ndaj kësaj Kompanie, mendoj që jo 13.000 euro të l ndahen por shumë më shumë do të duhej që ti ndaheshin.

z. Enver Berisha: Fillimisht, unë nuk pajtohem me atë që e tha Tunë Dedaj. Ne duhet ta kuptojmë situatën që jemi, gjendjen e pandemisë. Tjetër, sikurse të gjitha kompanitë e tjera edhe "Ambienti" i ka shqetësimet e veta në punë dhe në inkasim. Kërkesa për këto mjete që po mendohet të l ndahen nuk është q ë të paguhet stafi ose për shpenzime të paarsyeshme. Fjala është për blerjen e një makinerie që mbledh mbeturinat pasi që është defekt ajo ekzistuesja.

z. Zenun Elezaj, kryetar i Komunës: Përshëndetje për të gjithë anëtarët e Kuvendit. Komandat i Policisë, mirë se ke ardhur në Klinë. Këto mjete që kërkohet të ju ndahen, do të merren nga kategoria e subvencioneve. Edhe ne kemi vështirësi dhe ndarja e këtyre mjeteve do ta na lënë keq por duke llogaritur nevojën që kompania ka për këtë makineri dhe interesin tonë për shërbime sa më të mira për qytetarët e Komunës, kemi hyrë në një bashkëfinancim. Ne l ndajmë 13.000 euro ndërsa pjesën tjetër vet kompania. Qëllimi i Kompanisë është që të blejnë një kamion për mbledhjen e mbeturinave. Ndërkaq për përmirësimin e shërbimeve, natyrisht që ka vend dhe do të kemi mundësi që të debatojmë edhe më pastaj.

z. Sefa Morina: Përkundër situatës që kemi me COVID-19, kompania "Ambienti" janë munduar që ti kryejnë shërbimet ashtu siç duhet, prandaj unë dua ta falënderoj për këtë. Ne si grup Kuvendar i LDK-së e përkrahim këtë iniciativë.

Kryesuesi e nxori në votim dhe me 22 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, u MIRATUA propozimi për ndarjen e mjeteve në shumën 13. 000 euro për kompaninë e mbeturinave "Ambienti" në Klinë.

Pika 10 e Rendit të Ditës: Formimi i Komisionit për rimëkëmbje për shkak të pandemisë (7 anëtarë)

Kryesuesi i Kuvendit theksoi se ne koordinim edhe me shefat e grupeve Kuvendar si dhe me kryetarin e Komunës, është menduar që ky Komision të jetë në përbërje nga 7 anëtarë si dhe nga këta 7 anëtarë, 4 te jenë nga Kuvendi dhe 3 nga ekzekutivi. Gjithashtu në këtë koordinim është shprehur dëshira që shefat e grupeve Kuvendare të jenë anëtarët (4) nga Kuvendi.

Propozimin për përbërjen prej 7 anëtarëve (4+3), kryesuesi e vuri në votim dhe me 22 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, u MIRATUA.

Edhe përbërja e Komisionit nga 4 shefat e grupeve Kuvendare si dhe nga ekzekutivi: Aziz Desku, Hekuran Sejdiu dhe Naser Morina, i 'u nënshtrua votimit dhe me 22 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, u MIRATUA. Propozimi që kryetar i këtij Komisioni të jetë z. Aziz Desku u votua nga 22 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim.

Pika 11 e Rendit të Ditës: Formimi i komisionit për ndarjen e ndihmave

Kryesuesi sqaroi se për këtë komision duhet të jenë 5 anëtarë. Tre nga Ekzekutivi dhe 2 nga Kuvendi. Këta 2 nga Kuvendi propozoi që të jenë 1 nga pozita dhe 1 nga opozita.

z. Enver Berisha: Kemi ardhur në një pikë që është mjaft e ndjeshme. Pa dashur që të lëshohem në të kaluarën se si janë bërë ndarjet e ndihmave, kam dy kërkesa; 1. Ka të bëjë me kërkesën që është dërguar edhe me shkrim përmes juve z. kryesues, për komisionin që do të formohet tani. Është kërkuar që të kihet parasysh kategoria që nuk është subvencionuar deri tani nga niveli qendror. Fjala është për organizatat e dala nga lufta dhe familjet e të zhdukurve gjatë luftës, anëtarësia e tyre që nuk ka përfituar nga niveli qendror. Dhe 2. Është kërkesë e gr. Kuvendar dhe partisë demokratike që kjo pako të ketë vlerën prej 40 euro. Ne si grup kuvendar në kuadër të këtij Komisioni propozojmë z. Azdren Ramadani. Gjatë shpërndarjes së ndihmave kërkojmë që ky komision të koordinohet me të gjithë asamblistët dhe kryetarët e fshatrave. Kërkojmë gjithashtu që të jemi unik në këtë çështje sepse pandemia nuk na ka nda në parti politike, pra, të l trajtojmë të gjithë qytetarët barabartë.

z. Gjokë Lleshaj: Dua që të falënderoj iniciuesit e kërkesës për ndarjen e kësaj shumë për ndihmë qytetarëve. Duke u nisur nga përvoja e ndarjeve të kaluara, mbetet shumë për të dëshiruar prandaj kërkoj që në seancën e ardhshme të na sjellët një listë-raport se ku janë shpërndarë ndihmat deri tani. Uroi që të bëhet punë transparente dhe ndihmat të ndahen drejt e mirë kësaj radhe. Nuk kam asgjë kundër ndihmës për kategori të dala nga lufta, por propozoi që mos të bëhet dallim mes kategorive të ndryshme pasi që është gjithashtu edhe një kategori që nuk përfiton ndihma sociale dhe është në gjendje shumë të rënduar. Ashtu siç e tha Enveri, ky komision të koordinohet me kryetarët e fshatrave, me asamblistët por edhe me prift e hoxhë sepse edhe ata ndoshta më mirë se të tjerët e dinë gjendjen e familjarëve. Po ashtu pako, 40 euro vlera e sajë. Le të jetë 40 euro por jo të shkruaj në letër 40 euro e vlera të jetë më e vogël. Herën e kaluar vlera e një pakoje në treg ka qenë 12 euro, nuk e dijmë sa l ka shkruar por vlerë reale ka qenë 12 euro. (ndërhynë drejtori l administratës, z. Binak Sylaj dhe thotë se po aq ka qenë vlera e pakos 12 euro. Edhe në letra aq ka qenë e theksuar)

z. Zenun Elezaj, kryetar l Komunës: Besoj që gjatë rrugëtimit në përballje me këtë vështirësi në të cilën gjendemi do të l përgjigjemi në mënyrë të duhur, bashkë më ju t ë gjithë anëtarë të Kuvendit. E kemi pasur goxha të vështirë që të merremi më shpërndarje të ndihmave. Të jeni të bindur se këta tre njerëz që l ka caktuar shtabi l emergjencës, Aziz Deskun, Ilir Bacaj dhe Binak Sylaj, kanë pasur presion të madh, por sipas udhëzimeve dhe konsultimeve me personat që edhe ju l përmendet e kanë kryer punën në mënyrë më të mirë të mundshme. Dy herë ju kam sjellë raporte dhe jam gati që të debatojmë emër për emër çdo njërin që ka përfituar ndihma.

z. Esat Raci: Edhe unë l bashkëngjitëm kërkesës së anëtarit t Kuvendit, Gjokë Lleshaj, që në seancën e radhës të na vije një raport për komplet shpenzimet e 50 mijë eurove .

znj. Violeta Zefi: Në emër të grupit kuvendar të LDK, përgëzoj punën e mirë dhe profesionale që është bërë në këtë pandemi, njëkohësisht falënderojmë qytetarët për disiplinën e mirë të treguar gjatë kësaj kohe, urojmë që të vazhdojnë të jenë të tillë edhe në vazhdim. Gjithashtu, urojmë komandantin e policisë për mandatin e ri të tij. Sa l përket kësaj pike të rendit të ditës, ne si grup mendojmë se fillimisht duhet të behët një analizë e gjendjes shkaktuar si rezultat l Covid-19, dhe rrjedhimisht të identifikohen ato kategori që kanë më së shumti nevojë. Në këndvështrimin personal e kam një kërkesë specifike nëse është e mundur të bëhet një gjë e tillë; të ndihmohen fëmijët me nevoja të veçanta në Komunë, pasi që janë kategori më e cënueshme dhe familjet e tyre hasin shumë vështirësi. Jam e informuar se Elvira

Sejdiu ka bërë një kërkesë me shkrim dhe se ajo me siguri do ta prezantoj sot por I thash këto fjalë që të tregoj mbështetjen time për atë kërkesë.

z. Tunë Dedaj: Unë dëshiroj që të falënderoj shumë kryetarin e Komunës bashkë me ju kryesues dhe drejtorët, drejtorin e shëndetësisë, stafin. Kërkesa e Gjokës dhe Esatit në lidhje me raportin se nga kanë shkuar mjetet në shumë 50 mijë euro, është e mirë. Është mirë që të dihet dhe të jetë transparente. Kam qenë dakord që të ndahet shuma prej 90 mijë euro dhe dëshiroj që ato mjete-ndihma të shkojnë tek familjet vërtetë me nevojë. Nëse më pyet ndokush se a jam I kënaqur me menaxhimin e pandemisë në Komunën e Klinës nga ana e Qeverisë, them se JO nuk jam I kënaqur, sepse përveç fjalëve të mira që janë thënë asnjë ndihmë nga ana e qeverisë nuk ka ardhur në Komunën tonë. Është dashtë që çdo shtëpi të pajiset me maska dhe doreza. Është dashtë që t'i ndalohet dalja jashtë shtëpisë çdo personi mbi moshën 60 vjeçare. Këtyre të moshuarve është dashur që të organizohet dhe të ja dërgojnë bukën tek shtëpia dhe jo të lihen në mëshirën e zotit. KA shumë të kësaj moshe që kanë mbetur në shtëpi pa furnizime esenciale. Gjithashtu propozoj që ky komision të rritet në numër pak. Çdo grup kuvendar ta ketë një anëtar të komisionit si dhe partitë e tjera që kanë nga një e dy anëtarë të merren vesh mes vete dhe të kenë një anëtar në Komision.

z.Xhevxhet Berisha: Përshëndetje të gjithëve. Falënderoj grupin Kuvendar të PDK-së për këtë iniciativë të ndarjes së këtyre mjeteve si dhe Ekzekutivin që kanë gjetur mundësi që të ndahen këto mjete. I lutem Komisionit që të bashkëpunoj ngushtë me përfaqësuesit e fshatrave dhe BL sepse më mirë se sa përfaqësuesi I asaj bashkësie nuk mund ta dijë askush gjendjen. Dua të ndërlidhem me Tunën dhe fjalën e tij të më hershme. Në situatë pandemie mund të ketë shkelje, edhe në Amerikë pashë që kishte protesta për shkelje, por mendoj që këto shkelje të themi kushtetuese ose të të drejtave të njeriut në kohë pandemie, janë shkelje pozitive pasi që janë shkelje në interes të qytetarit. Me heqjen e karantinës kam parë shumë qytetarë duke shëtitur nëpër qytet pa asnjë nevojë. Ju lutem të gjithëve që mos të dalin pa nevojë. Ti reduktojnë lëvizjet sepse një epidemi në përmasa më të mdhaja në vendin tonë do të ishte shumë e rëndë duke e ditur se çfarë gjendje të institucionit kemi.

z. Binak Sylaj, drejtor I Administratës: Me vëmendje I dëgjova të gjithë dhe është normale interesimi I të gjithëve për rrjedhat edhe të pandemisë por edhe të menaxhimit dhe përkrahjes së ofruar për qytetarët. Unë jam një nga anëtarët që kam pasur fatin të jem në komisionin për shpërndarjen e ndihmave. Ju garantoj se jemi konsultuar me përfaqësues fshatrash, me të gjitha kategoritë e tjera e në veçanti me kategoritë e dala nga lufta, pjesë e të cilave jam edhe unë dhe kërkesat e tyre janë marr për bazë nga fillimi deri në fund për të gjitha ato mjete që janë ndarë nga shtabi emergjent dhe me të cilat jemi furnizuar me ndihma. Është mirë që të konsultoheni direkt me këto kategori të dala nga Lufta dhe të I pyesni se a kanë vërejtje apo jo dhe jo të thuhet këtu se ka vërejtje në ndarje. Unë e di se nuk ka vërejtje sepse kam qenë në kontakt të vazhdueshëm me të gjithë. Çdo kërkesë e qytetarit në adresë të Komunës për dhënie të ndihmës, në konsultim me përfaqësuesin e fshatit I është dhënë ndihma e kërkuar sipas mundësisë që kemi pasur. Gjoka shprehu pak dyshime në lidhje me shpërndarjen e ndihmave, dhe kontaktit që kemi pasur me përfaqësues të fshatrave, lagjeve etj. mendoj që nuk është reale sepse ata përfaqësues- kryetar të fshatrave janë caktuar që në vitin 2000 dhe përveç fshatit Gremnik që ka zgjedhë kryetarin e ri, të tjerat fshatra akoma nuk kanë zhvilluar zgjedhje të reja për kryetar të tyre. Këta kryetar të fshatrave ekzistues janë kontaktuar gjithmonë që nga viti 2000 e deri tani. Unë ju kuptoj sepse ju jeni pikërisht përfaqësues të asaj popullate por edhe propozimet e juaja për ndonjë familje të varfër është përfshirë në përfitimim e pakos ushqimore. Mos t'ë shërbehemi me thash e thëna dhe mos t'ë bëjmë politikë në kohë pandemie. Angazhimi I kryetarit dhe stafit ka qenë shumë I

madh por edhe përkrahja e qytetarëve në respektimin e sugjerimeve të shtabit të emergjencës dhe Institutit shëndetësor në nivel vendi. Të gjitha ndihmat që janë ndarë në ky komision kanë me qenë publike dhe do ta shikoni se si është gjendja reale. Asnjëherë nuk është menduar politikisht në ndarjen e ndihmave dhe nuk ja lejoj vetes të ndodhë një gjë e tillë. Gjoka përmendi priftin dhe hoxhën që do të duhej angazhuar në konsultime. Ju informoj se gjatë shpërndarjes së ndihmave, kemi pasur një kërkesë nga Prifti I cili na ka ofruar një listë me emra familjesh në nevojë dhe ajo listë është përfshirë në tërësi, ato familje janë furnizuar me pako ushqimore. Gjithashtu edhe bashkësia Islame në Klinë ka siguruar një donacion ndihmash të cilat bashkë me shtabin emergjent dhe QPS I kanë shpërndarë familjeve me nevojë. Kjo është e vërteta dhe jemi këtu që të ballafaqohemi me të vërtetën dhe vetëm më të vërtetën.

Kryesuesi konfirmon edhe një herë pjesëmarrjen e anëtarëve në seancë pasi që seancës ju bashkua edhe një anëtar, z. Tush Dedaj. Dhe se tani janë prezent 23 anëtarë.

Znj. Elvira Sejdiu: Përshëndetje të gjithëve. Para disa ditëve në mënyrë elektronike kam bërë një kërkesë në adresë të kryetarit të Komunës, Kryesuesit dhe drejtorit të shëndetësisë. Dëshiroj që ta lexoj edhe këtu kërkesën time. Shpresoj që komisioni të gjejë formën dhe mundësinë që të e ndihmoj edhe një kategori shumë të ndjeshme, familjet që kanë fëmijë me nevoja të veçanta, sidomos ato familje që kanë fëmijë me autizëm dhe sindromën doën.

z. Gjokë Lleshaj: (replikë) Pleqtë kanë thënë përpara “ Kush e ka mizën nën kapuç e djegë”. Askënd nuk e akuzova drejtë për drejtë, por që ka pas anashkalime, ka pas. Që nuk kanë përfituar njerëz që është dashtë të përfitojnë edhe kjo ka ndodhë. Nëse doni jam gati që afër 30 familje të tilla të jua përmend tani të cilat I kam pyetur dhe e kanë konfirmuar që s’ kanë marrë asnjë ndihmë. Nuk po them që janë keqpërdorë ndihmat, por nuk kanë përfituar familje që kanë nga 7-8 fëmijë dhe pa asnjë të ardhur, I kam emrat e tyre mund të jua lexoj këtu. Unë I Zllakuqanit jam, tregomëni kë e keni konsultuar në Zllakuqan për ndarje të ndihmave. Nuk jam tuj ba politikë, po e ngrit zërin për këto familje që nuk ju janë dhënë ndihma edhe pse e kanë pasur shumë të nevojshme.

z. Enver Berisha: Kur e morra fjalën rreth kësaj pike të Rendit të Ditës u mundova që ta kanalizoj pak situatën në drejtim pozitiv për faktin se janë dy çështje. E para është se nuk jemi në pikë të rendit të ditës ku bëhet vlerësimi I raportit të punës së Komisionit por jemi në pikën e formimit të komisionit për ndarjen e ndihmave nga mjetet e ndara prej 90 mijë euro, kërkesë e PDK-së e cila e ka bërë në seancën e jashtëzakonshme të thirrur për atë qëllim. Ndaj mendimin që në një seancë të ardhme të diskutohet një raport I punës së komisionit për ndarje të ndihmave si dhe pasi që ka interesim nga Kuvendi, ky komision tani të rritet edhe për dy anëtarë më shumë. Këta dy anëtarë të jenë nga Kuvendi, një nga opozita dhe një nga pozita dhe të bëhet komision prej 7 anëtarëve; 4 nga kuvendi dhe 3 nga ekzekutivi.

Z. Fadil Gashi, kryesues I Kuvendit: Unë kam planifikuar që të ju falënderoj në fund juve si anëtarë të Kuvendit për tre seanca që I kemi mbajtur në formë elektronike dhe ju I jeni përgjigjur me votën e juaj. Seanca e parë ka qenë rreth ndarjes së 50 mijë eurove për ndihma. Në seancën e dytë të jashtëzakonshme është votuar për lirim të qytetarëve nga participimi në shërbimet shëndetësore dhe seanca e tretë ajo për ndarjen e 90 mijë eurove prap për ndihma në pako ushqimore dhe higjienike. Këto janë mjetet që janë ndarë nga Komuna e Klinës për qytetarët tanë për të gjitha kategoritë dhe pa përjashtime. Ju falënderoj të gjithëve që I jeni përgjigjur pozitivisht me votën tuaj dhe them se këtu është vetëm një kategori, ajo në nevojë që pret ndihmën e Komunës gjithashtu. Jam pjesë e shtabit emergjent dhe kam pa edhe përpjekjet edhe vështirësitë e shtabit e të komisionit. Me siguri keni parë që ato ditë ka pasur numër të qytetarëve në Komunë, me arsye e ndoshta edhe pa arsye. Disa janë të

gatar ashtu që gjithmonë kërkojnë ndihmë dhe se përfitojnë edhe nga tre e katër herë; nga Komuna, nga bashkësia Islame, ajo Katolike, nga Halil Kastrati etj. I është adaptuar asaj mënyre. Ndërsa disa të tjerë janë ndryshe, ju vjen keq me ardhë e me kërkuar ndihmë, pret që të l shkohet në shtëpi. Prandaj dëshiroj që këto komisione që janë formuar e formohen, të jenë të angazhuar për secilin që ka nevojë pavarësisht se ku është në territor të Komunës sonë. Gjendja ekonomike ka ndryshuar nëpër familjet tona. Kategoritë sociale kanë marrë nga dy paga shtesë ndërkohë që një kryefamiljar që ka punuar në një kompani private ka mbet pa punë dhe pa të ardhura. Pra, kjo është puna e Komisionit, pa emocione, pa ngjyrimet politike të orientoj ndihmën aty ku është mese e nevojshme. Edhe unë nuk jam që të bëjmë fasadë me pako-ndihmën. Të dërgojmë një pako sa për formalitet, por që ajo pako të ketë një vlerë të mirë dhe të jetë vërtetë ndihmë por është komisioni që do të vendosë për vlerën e pakos. Përndryshe, e thash edhe në fillim, unë jua kam përcjellë dy raporte të kryetarit me qellim që të jemi sa më afër juve anëtarë të Kuvendit dhe për të qenë sa më të informuar për punën që po bënë Komisioni. Kjo nuk do të thotë që nuk duhet të ketë raporte të tjera. Nëse ka pasur anashkalime apo "rrëshqitje" ajo ka mundur të vijë jo vetëm nga Komuna por edhe nga të tjerë që kanë shpërndarë ndihma dhe në këso rastesh më së lehti është me ja adresuar Komunës. Nuk do të doja që të lëshohemi sot në këto debate pasi që janë raportet që në seancën e radhës do të na l sjell ky komision por edhe komisioni tjetër më pastaj. Me rëndësi është që të gjitha ndihmat janë shpërndarë tek familjet e Komunës së Klinës. Nëse ndonjërin nga familjarët nuk e ka vra ndërgjegjja dhe ka marrë ndihmën pa pasur nevojë, edhe ne si kuvend po pajtohemi, le ta merr. Pasi që ka ardhur në atë gjendje me marr ndihmë pa pasur nevojë, në emër të juaj po ja fali. Le ta mbanë në ndërgjegje. Tani kur ta formojmë këtë komision dhe të ballafaqohet me ndarjen e ndihmave, e dij që ka me pasë anëtarë që kanë me kërkuar që të tërhiqen nga Komisioni, nga presioni që kanë me pasë.

z. Zenun Elezaj, kryetar i Komunës: Nuk kam asgjë kundër që ky Komision të përbëhet nga 7 anëtarë . Ju lutem që të bashkëpunoni ngushtë me anëtarët e tjerë të kuvendit dhe të keni parim që çdo familje që kërkon ndihmë, të l epet ndihmë në këtë kohë pandemie. Natyrisht që do të ju vije raporti për ndihmat e ndara deri tani edhe pse besoj që një raport të tillë jua kam dërguar por pa specifiku emra për shkak të ndjeshmërisë së situatës. Gjithçka që është punuar është e shkruar dhe kush të dojë mund të l shikoj edhe emrat e përfituesve. Me gjithë këtë sido që të vendosë Kuvendi, ne jemi të gatshëm që të përgjigjemi.

Znj. Saranda Elezi: Përshëndetje të gjithëve. Jam dakord që komisioni të shtohet siç u propozua dhe që ky Komision të bashkëpunoj ngushtë më anëtarët e tjerë të Kuvendit në mënyrë që të merren mendimet e anëtarëve me qellim të mbarëvajtjes së punës.

Znj. Xhezide Gashi-Trepça: Përshëndetje të gjithëve. Morra fjalën që ta përshëndes iniciativën e Elvira Sejdiut të përkrahur edhe nga Violeta. Është e vërtetë që familjet të cilat kanë fëmijë me nevoja të veçanta duhet të përfshihen në këtë pako ndihmash sepse kanë nevoja vërtetë të domosdoshme.

z. Valmir Bacaj: Nuk mendova ta marr fjalën por n a devijuan nga Rendi I Ditës. Nuk është e drejt të sulmohet një komision l cili nuk ka prezantuar akoma raport të Punës. Po ashtu është e padrejtë të sulmohet një komision që nuk është në përbërje të plotë këtu prezent. E po ashtu është shumë lehtë duke qëndruar në shtëpi gjatë gjithë kohës së pandemisë e të sulmohet një komision që gjatë kësaj kohe është ballafaquar me problem të ndryshme dhe ekspozuar rrezikut nga infektimi. Do të l lutesha të gjithëve që mos t ë bëjmë politikë në kohë të pandemisë sepse kemi kohë të mjaftueshme që të bëjmë politikë më pastaj.

z. Sefa Morina: Përshëndetje për të gjithë. Mua ma merr mendja që nuk është dashur që ta bëjmë këtë debat në këtë kohë pandemie. Propozoj që mos të vazhdohet më tej me këtë debat. Komisionit I sugjeroj që të na kontaktoj lirisht nëse ka nevojë për ndihmën tonë në teren.

Kryesuesi z. Gashi bëri një përmbledhje rreth propozimeve për komisionin që ati ti shtohen edhe dy anëtarë. Ndërsa z. Enver Berisha theksoi se është edhe propozimi për shumën e pakos. Kjo e fundit u vendosë që të përcaktohet nga Komisioni. Kryesuesi ngriti edhe një dilemë që nuk e ka të njohur proceduralisht, në lidhje me pakon përfituese nga familjet që kanë vetëm dy anëtarë dhe ato që kanë më shumë se dy (shembull). Ai pyeti nëse ka mundësi të bëhet dallimi pozitiv për familjet që kanë shumë anëtarë të familjes nga ato që kanë pak anëtarë të familjes.

z. Xhevxhet Berisha: Kryetarët e fshatrave e dinë më së miri se sa anëtarë familjeje ka përfituesi dhe mendoj që nuk do të duhej të ishte barabartë sikurse një familje me pak anëtarë sikurse ajo më shumë.

Komisioni I propozuar në përbërje të : Azdren Ramadani, Gjokë Lleshaj, Xhevxhet Berisha, Blerta Gashi, Binak Sylaj, Aziz Desku dhe Ilir Bacaj u vendos në votim dhe me 24 vota për , asnjë kundër dhe asnjë abstenim u MIRATUA. Ndërsa kryetar I Komisionit u propozua dhe u votua z. Gjokë Lleshaj.

Pika e 12 e Rendit të Ditës: Propozim-Vendimi për lirim të përkohshëm nga gjobat për kategoritë: Regjistrimi I Lindjeve, regjistrimi I vdekjeve si dhe shtyrja e afateve për shpenzimet e varrimit, nga data 13 mars 2020.

Kryesuesi z. Gashi e vuri në votim dhe me 24 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, u MIRATUA.

Me përfundimin e pikës së 12 të rendit të ditës kryesuesi I Kuvendit shpallë të mbyllura punimet e seancës duke falënderuar të gjithë për punën dhe angazhimin.

Procesmbajtës:

Skënder Behramaj

